



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në vazhdimin e dytë të seancës së 55-të, të mbajtur më datë 18.11.2021morri,

VENDIM

Procedura e KSHPK-së për lëndën numër 08-3462/1 nga 05.10. 2020, e formuar me vetiniciativë , për shkelje të dispozitave të nenit 82 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit nga /// ish-deputet i Republikës së Maqedonisë së Veriut, NDËRPRITET.

Konstatohet se pas kërkesës së parashtruar për ngritjen e procedurës kundërvajtëse kundër -----, ish-deputet i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni për Kundërvajtje në KSHPK miratoi Aktvendim me nr. /// të datës /// me të cilin e shpalli përgjegjës për kundërvajtje personin e emëruar nga neni 82 paragrafi 3 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe i shqiptoi sanksion kundërvajtës me gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë të denarit.

KSHPK -ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda e regjistruar me numër 08-3462/1 të datës 05.10.2020 është formuar me vet - iniciativë.

KSHPK-ja nga kontrollimi i evidencave të saj ka konstatuar se personit ///, me datë /// i është ndërprerë funksioni si deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe se ai nuk ka dorëzuar listë anketuese në KSHPK brenda afatit të përcaktuar me ligj prej 30 ditësh nga përfundimi i funksionit.

Për shkak të lartpërmendurës, KSHPK-ja personit të emëruar i ka lëshuar urdhërpagesë për kundërvajtje me nr. /// të datës /// për shkelje të kryer nga neni 82

paragrafi 3 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, dënueshëm sipas nenit 109 nga i njëjti ligj.

Personi i emëruar nuk ka vepruar me urdhërpagesë për kundërvajtje në afatin e përcaktuar me ligj, për çka KSHPK ka paraqitur kërkesë në Komisionin për Kundërvajtje në KSHPK për ngritjen e procedurës për kundërvajtje ndaj personit të caktuar.

Komisioni për Kundërvajtje në KSHPK me Vendimin nr. /// të datës /// e shpalli përgjegjës për kundërvajtje personin e emëruar nga neni 82 paragrafi 3 i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe shqiptoi sanksion për kundërvajtje GJOBË në shumë prej 400 euro në kundërvlerë të denarit.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti:
Miratoi:

KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Kryetar
Biljana Ivanovska

